



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 21 shtator 2021

Njoftim për shtyp

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: gusht 2021

- Në gusht të vitit 2021, **para e gjerë (agregati monetar M3¹²)**, krahasuar me muajin e kaluar shënoi rritje prej 1,6%. Ndryshimi në rritje kryesisht është rezultat i rritjes së depozitave të parave, gjatë rritjes më të vogël edhe tek depozitat afatshkurtra dhe ato afatgjata deri në 2 vite, kurse paratë e gatshme në qarkullim shënojnë rënie. Në bazë vjetore para e gjerë shënoi rritje për 11,5 %, në pjesë më të madhe e ndikuar nga rritja e depozitave të parave dhe depozitave afatshkurtra, në kushte të rritjes më të vogël edhe tek komponentët tjerë.

Tabela 1. Totali i depozitave dhe kredive^{3 4} të sektorit joqeveritar

	sostojba (во милиони денари)						годишна промена (во %)						месечна промена (во %)	
	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	6.2021	7.2021	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	6.2021	7.2021	6.2021	7.2021
Парична маса M4	455,834	468,912	469,050	486,989	500,202	504,486	8.9	9.8	6.9	6.9	6.7	7.1	0.8	0.9
Парична маса M3	403,714	416,935	418,556	436,231	451,639	456,413	8.3	9.7	7.6	8.0	8.3	8.7	1.1	1.1
од кои:														
Готови пари во оптик	37,891	41,125	41,667	43,701	43,604	46,267	21.3	26.3	24.9	21.0	6.0	10.0	-0.8	6.1
Вкупни депозити	409,200	418,916	418,644	434,915	447,237	448,933	8.3	8.4	6.1	5.9	6.8	6.8	1.0	0.4
од кои:														
Корпоративен сектор	108,138	110,550	112,505	123,212	128,970	128,538	12.5	11.2	8.0	10.1	16.7	17.1	3.1	-0.3
Во денари	75,876	77,609	79,641	86,323	88,994	87,026	13.8	9.3	5.4	5.4	14.7	13.8	3.2	-2.2
Во странска valuta	32,261	32,941	32,865	36,889	39,976	41,512	9.5	15.9	14.9	22.8	21.4	24.6	2.9	3.8
Домаќинства	275,574	280,512	278,469	285,216	292,359	293,601	8.6	8.7	6.1	4.6	4.2	4.3	0.3	0.4
Во денари	147,532	149,204	145,806	150,991	152,597	152,982	11.9	10.1	6.2	3.3	2.3	2.6	-0.4	0.3
Во странска valuta	128,042	131,309	132,663	134,225	139,762	140,619	5.1	7.1	6.0	6.2	6.4	6.2	1.1	0.6
Вкупни кредити	343,702	352,718	352,824	357,296	370,862	373,561	5.8	6.6	7.3	4.7	5.1	5.2	1.0	0.7
од кои:														
Корпоративен сектор	167,654	172,978	168,086	169,826	175,067	176,577	1.8	4.6	5.2	1.1	1.2	2.0	0.6	0.9
Во денари	103,597	106,688	101,925	102,688	106,876	107,196	0.4	3.3	2.7	-0.9	0.2	-0.1	0.2	0.3
Во странска valuta	64,057	66,290	66,161	67,138	68,191	69,381	4.0	6.9	9.3	4.3	2.9	5.6	1.4	1.7
Домаќинства	174,634	178,384	183,431	185,814	193,906	195,123	10.1	8.8	9.5	8.0	8.7	8.0	1.3	0.6
Во денари	96,643	99,469	103,939	105,049	109,484	110,355	8.8	8.7	12.0	10.5	10.1	9.0	1.0	0.8
Во странска valuta	77,990	78,916	79,492	80,765	84,422	84,767	11.9	8.9	6.4	5.0	7.0	6.7	1.6	0.4

Burimi: BPRMV.

¹ Duke filluar nga qershori i vitit 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si një përkufizim i ri standard për paranë e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetare M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.

² Agregatin monetar M1 e përbëjnë paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat pa afat. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati M1 bashkë me depozitat afatshkurtra, ndërsa agregati monetare M3 (para e gjerë), përveç agregatit monetar M2 i përfshin edhe depozitat me maturitet nga një deri në dy vjet. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 përbëhet prej agregatit monetar M3 dhe depozitat afatgjate me maturitet mbi dy vjet. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë: http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_monetarna_07_2018_mak.pdf



³ Normat vjetore të kredive në periudhën nga korriku 2019 këndej janë nën ndikimin e efekteve nga masat e BPRMV-së për fshirjen e kredive që janë plotësisht të të mbuluara për më shumë se një vit.

⁴ Të dhënat për agregatet monetare, si dhe totali i depozitave dhe kredive deri në gusht të vitit 2020, nuk i përfshijnë të dhënat për një bankë të cilës në gusht të vitit 2020 i është revokuar leja për themelim dhe punë dhe për të cilën është iniciuar një procedurë falimentimi.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në gusht, **depozitat totale**⁵ shënuan rritje mujore dhe vjetore prej 1,8% dhe 9,9%. Rritja e depozitave është rezultat i depozitave më të larta tek të dy sektorët, me pjesëmarrje më të theksuar në rritjen mujore dhe vjetore të depozitave të sektorit të korporatave.
- Në gusht, **kreditë totale**⁶ janë zvogëluar për 0,3% në bazë mujore, kryesisht si rezultat i rënies së kredive të sektorit të korporatave. Analizuar në bazë mujore kreditë totale janë më të larta për 6,4% të ndikuara nga rritja e kredive tek të dy sektorët, me kontribut më të madh të sektorit "amvisëri".



Burimi: BPRMV

1. Depozitat dhe kreditë të sektorit të korporatave⁷



Burimi: BPRMV

⁵ Totalin e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshirë në agregatin monetare M4


⁶ Më 9 gusht të vitit 2018, Këshilli i Bankës Popullore e miratoi Vendimin mbi metodologjinë për administrimin e rrezikut të kredisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 149/18), sipas së cilës bankat janë të detyruara t'i transferojnë nga evidenca e bilancit në evidencë jashtë bilancit (dhe të vazhdojnë me transferimin e) të gjithë kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vit. Vendimi për metodologjinë e administrimit të rrezikut të kredisë filloi të zbatohet nga 1 korriku i vitit 2019, duke shterur kështu efektin e bazës së krahasimit në korrik të vitit 2020. Prandaj, ndryshimet në normat vjetore të ndryshimit të kredive me dhe pa efektin e fshirjeve të kryera janë të parëndësishme, për shkak të së cilës nga njoftimi i muajit gusht këndeje këto krahasime janë ndërprerë.

⁷ Për qëllimet e këtij njoftimi, sektori i korporatës përfshin kompani publike dhe private jofinanciare



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në muajin gusht, **depozitat totale të sektort të korporatave** shënuan rritje prej 4,0% në bazë mujore, si rezultat i rritjes së të gjithë komponentëve, e cili është më e theksuar tek depozitat e parave dhe depozitat afatshkurtra në valutë të huaj. Në bazë mujore, depozitat totale të sektorit të korporatave shënuan rritje prej 20,2%, e cila në masë më të madhe është rezultat i depozitave të parave më të larta dhe depozitave afatshkurtra dhe afatgjata në valutë të huaj, gjatë rënies së depozitave afatshkurtra në denarë.
- Këtë muaj, **kreditë e sektorit të korporatave**⁸, janë zvogëluar për 0,8% në bazë mujore, para së gjithash për shkak të rënies së kredive të miratuara në valutë të huaj dhe me ndikim më të vogël edhe nga rënia e kredive në denarë. Krahësuar në bazë vjetore, tek këto kredi është regjistruar rritje prej 4,5% e cila në masë më të madhe është rezultat i kredive të miratuara në denarë.



Burimi: BPRMV

2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive⁹



Burimi: BPRMV


⁸ Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj

⁹Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe personave të vetëpunësuar





Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në muajin gusht, **depozitat totale të amvisërive** shënuan rritje mujore prej 0,9% e cila kryesisht është rezultat i rritjes së depozitave në para dhe depozitave afatshkurtra në valutë të huaj, gjatë rënies së shënuar tek komponentët tjerë. Krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, këto depozita janë më të larta për 7,4% të ndikuara nga rritja e parave të depozituara dhe depozitave afatshkurtra në valutë të huaj dhe depozitave në denarë, kurse depozitat afatgjate në denarë dhe depozitat në valutë të huaj shënojnë rënie.
- Në gusht, kreditë e amvisërive, janë rritur për 0,2% si rezultat i rritjes së kredive në denarë dhe në valutë të huaj, e cila është pak më e theksuar tek kreditë në valutë të huaj. Rritja vjetore shënon 7,9% dhe është rezultat i rritjes së kredive të miratuara në të dyja valutat, me kontribut më të madh të kredive në denarë.



Burimi: BPRMV



Burimi: BPRMV



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Drejtoria për Statistikë

Tabela 2. Kredi të bankave dhe shtëpive të kursimeve të dhëna personave fizikë, sipas qëllimit

	состојба (во милиони денари)						годишна промена (во %)						месечна промена (во %)	
	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	6.2021	7.2021	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	6.2021	7.2021	6.2021	7.2021
Потрошувачки кредити	93,440	94,982	97,850	98,772	102,516	103,324	13.5	10.0	9.9	6.9	7.9	7.4	1.3	0.8
Станбени кредити	52,959	54,392	55,985	58,306	62,384	63,651	13.9	13.8	14.0	13.6	14.7	15.1	1.9	2.0
Автомобилски кредити	306	292	291	282	242	239	-4.1	-8.6	-7.9	-10.9	-17.1	-17.3	-2.9	-1.5
Кредитни картички	11,570	11,508	11,649	11,205	10,488	10,465	-4.5	-4.2	-2.6	-6.1	-8.9	-9.5	0.5	-0.2
Негативни салда по тековни сметки	6,499	6,205	6,280	5,818	6,419	6,273	-4.8	-9.4	-10.8	-5.0	3.4	4.2	-0.4	-2.3
Други кредити	3,969	3,946	3,912	3,871	3,687	2,899	-6.7	-6.4	-6.7	-6.0	-6.6	-26.3	0.6	-21.4

Burimi: BPRMV.

- Në gusht, analizuar sipas qëllimit të kredive të miratuara për personat fizik, **kreditë konsumatore**, si kategori më e zakonshme mbetën të pandryshueshme në bazë mujore, ndërsa në bazë vjetore më të larta për 6,9%. **Kreditë për strehim** janë rritur për 0,6% dhe 16,2% në bazë mujore dhe vjetore. Këtë muaj **kreditë për automjete** shënuan rënie mujore dhe vjetore për 1,1% и 17,5%, ndërsa kreditë e miratuara në **kartelat kreditore** janë zvogëluar për 0,4% dhe 9,9% në bazë mujore dhe vjetore. **Në gusht bilancet negative në llogaritë rrjedhëse**, janë zvogëluar për 0,2% në bazë mujore, gjatë rritjes vjetore prej 1,8% ndërsa kreditë e miratuara në baza tjera shënojnë rënie mujore dhe vjetore prej 1,1% и 27,1%.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: Balance dhe pasqyra të institucioneve depozituese, të dhëna mujore: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika.nspk

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_monetarna_07_2018_mak.pdf

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesit:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimi të të dhënave:

http://nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: 21 tetor të vitit 2021 (mesatare referuese me shator 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 110/108).